

Isamet BAKIU

ROLI I SHTETIT AMË TË SERBËVE DHE PUSHTETNDARJA NË KOSOVË

Abstrakt:

Republika e Kosovës, si një shtet i ri me një çështje të hapur të njohjes ndërkombëtare të plotë dhe një mosnjohje zyrtare nga Serbia që përfundimisht do të garantonte paqe afatgjate, po ballafaqohet me një imponim të mekanizmit të menaxhimit ose zgjidhjes së konflikteve siç është pushtetndarja e që në anglisht njihet si term makropolitik “power sharing”. E kaluara ka dëshmuar se marrëveshjet si ajo e Dejtonit (1995) dhe Marrëveshja Kornizë e Ohrit (2001) kanë ardhur si mekanizëm për të ndaluar konfliktet dhe si bazë për të ndërtuar pushtetndarjen. Ngjashëm ishte edhe Marrëveshja e Rambujesë (1999), e cila u refuzua nga pala serbe. Inskenimi i një konflikti në Kosovë dhe viktimizimi i popullatës serbe në komunat në veri do të sillte te një skenar i rinegocimit dhe imponimit të një zgjidhjeje territoriale. Faktorët që e imponojnë këtë janë shteti amë i serbëve - Republika e Serbisë, por edhe faktorët ndërkombëtarë që ndikohen nga diplomacia serbe dhe ruse. Politika serbe e kthimit të pushtetit serb në Kosovë rrit shpresat dhe pengon serbët të integrohen në institucionet e Republikës së Kosovës. Realisht Kosova nuk është shtet me të gjitha elementet e pushtetndarjes ose demokracisë konsociale dhe mu këtu është koncentrimi i imponimit politik të shtetit amë serb. Si të fuqizohet pushteti i serbëve minoritar dhe si të mbetet ndikimi i shtetit serb në Kosovë përmes elementeve të demokracisë konsociale e sidomos përmes elementit të katërt të pushtetndarjes siç është

autonomia territoriale që synohet përmes bashkimit të komunave të veriut e njohur në opinion me termin serb si “zajednica”. Metodologjia e përdorur në këtë artikull është përmes përshkrimit të elementeve të pushtetndarjes dhe krahasimit të tyre me shtetet si Maqedonia e Veriut dhe Bosnjë- Hercegovina. Përshkrimi i Kosovës përmes elementeve si përfaqësimi proporcional, koalicionet e zgjeruara, të drejtën e vetos dhe autonomisë territoriale ose joterritoriale si dhe krahasimi i ndërthurtë argumenton tendencat që të drejtat minoritare të avancohen në të drejta të popullit shtetformues.

Fjalët kyçe: *Kosova, pushtetndarja (power sharing), demokracia konsociale, përfaqësimi proporcional, koalicionet e zgjeruara, e drejta e vetos, autonomia.*

Koncepti i shtetit amë për serbët dhe shqiptarët

Si për Shqipërinë dhe shqiptarët ashtu edhe për Serbinë dhe serbët koncepti i shtetit amë nuk është i vetmi koncept. Për nacionalistët serbë shtete të “originës” janë edhe Mali i Zi, Bosnjë-Hercegovina dhe Kroacia dhe gjithmonë kur ata llogarisin Kosovën si pjesë integrale.¹ Prandaj ata hasin në vështirësi kur shtetin amë duhet definuar në korniza të shtetit të Serbisë. E njëjta mund të kalkulohet edhe për shqiptarët. Shqiptarët që historikisht në fillim u njohën në

¹ Kushtetuta e Republikës së Serbisë: “Duke u nisur nga tradita shtetërore e popullit serb dhe barazia e të gjithë qytetarëve dhe bashkësive etnike në Serbi, duke u nisur nga fakti se Krahina e Kosovës dhe Metohisë është pjesë përbërëse e territorit të Serbisë, se ajo ka pozitë të autonomisë thelbësore në kuadër të shtetit sovran të Serbisë dhe se nga pozita e tillë e Krahinës së Kosovës dhe Metohisë rrjedhin obligimet kushtetuese të të gjitha organeve shtetërore për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat shtetërore të Serbisë në Kosovë e Metohi në të gjitha marrëdhëniet politike të brendshme dhe të jashtme, qytetarët e Serbisë sjellin...”.

Shih: https://www.paragraf.rs/propisi/ustav_republike_srbije.html

Shqipërinë londineze (1912-1913)² dhe së fundmi me Republikën e Kosovës (2008) ballafaqohen me një fenomen të ri të “dy shteteve amë,” por kjo më shumë për shqiptarët jashtë këtyre dy shteteve “shqiptare,” edhe pse Kosova në preambulë definohet si shtet qytetar.³

Kundërshtarët e bashkimit kombëtar shqiptar kanë krijuar një fajësim se shqiptarët duan një Shqipëri të Madhe me territor etnik ku të jetojnë të gjithë shqiptarët bashkë. Në realitet kjo është realizuar për serbët. Ata janë zgjeruar vazhdimisht dhe kanë pasur historikisht mundësinë që të jetojnë bashkë në një shtet siç ka qenë Mbretëria Jugosllave dhe RSFJ-ja.⁴ Nostalgjia për këtë është edhe lëvizja për “Botën Serbe” që po deklarohet si imitim i “Botës Ruse”. Bashkimi i Shqipërisë me Kosovën mbetet në kontekstin teorik të ideve të bashkimit dhe jo të realitetit politik të kohës.

Shpesh propozimi që termi “vend amë” të zëvendësohet me termin “Republika e Serbisë apo Republika e Shqipërisë” për serbët apo shqiptarët e ngelur në shtete tjera krijon ndjenjën e përjashtimit nga qendra etnike. Kjo vlen të përmendet, sepse shtetet i konsiderojnë interes kombëtar marrëdhëniet me diasporën. Serbët nga Republika Sërbska në diasporë e kanë shtet amë Serbinë apo Bosnjë-Hercegovinën, ose shqiptarët nga Kosova në diasporë e kanë shtet amë Kosovën apo Shqipërinë? Në realitet ata kanë shtetin e lindjes

² Vickers, Miranda. *The Albanians: A Modern History* (I.B. Tauris, 2001); Beqir Meta, Marenglen Verli, Muhamet Shatri, *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX, Vëllimi I*, Botimet Albanologjike, Tiranë 2017, 49-89.

³ Preambula e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, “Ne, populli i Kosovës, të vendosur për të ndërtuar një ardhmëri të Kosovës si një vend i lirë, demokratik dhe paqedashës, i cili do të jetë atdhe i të gjithë qytetarëve të vet; të përkushtuar për krijimin e një shteti të qytetarëve të lirë, i cili do të garantojë të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit; të zotuar që Kosova të jetë shtet i mirëqenies ekonomike dhe i prosperitetit social”.

⁴ Sabrina Ramet, *The Three Yugoslavias: State-Building and Legitimation, 1918-2005*,

<https://books.google.mk/books?id=FTw3IEqi2->

[oC&pg=PA35&source=gbs_toc_r&cad=2#v=onepage&q&f=false](https://books.google.mk/books?id=FTw3IEqi2-oC&pg=PA35&source=gbs_toc_r&cad=2#v=onepage&q&f=false)

dhe shtetin apo shtetet ku janë rezident. Prandaj koncepti shtet amë në demokracinë moderne e humb kuptimin që ka për vendin e origjinës. Për arsye krejtësisht historike dhe gjeostrategjike shqiptarët që kanë ngelë në një shtet që është krijuar në trojet e tyre etnike nuk do të thotë që entiteti politik është vendi i tyre i origjinës.

Politikat e spastrimit etnik e kanë parë me interes “shtetin amë” për t’i dëbuar shqiptarët në “vendin e tyre të origjinës”. Kjo ka ndodhur edhe me rastin e dëbimit të popullatës shqiptare të Kosovës në vitin 1999⁵ ose pastrimi etnik i Çamërisë 1944.⁶

Sidoqoftë në këtë punim nuk është aq me rëndësi origjina e popullatës apo historiku dhe pastrimi etnik, por ndarja e pushtetit mes popullatave shumicë dhe atyre më të vogla ose pakicë në entitetet ku kufijtë njihen ndërkombëtarisht, më saktësisht ndarja e pushtetit si mekanizëm makropolitik.

Çështja më koncize është në njërën anë sesa në realitet bën shteti amë Serbia për minoritetin serb në Kosovë dhe sa e pengon apo e ndihmon ajo fuqizimin me pushtet dhe integrimin e serbëve në Kosovë. Në anën tjetër është me rëndësi edhe ndihma dhe kontributi i shqiptarëve jashtë entiteteve politike, shteteve si Shqipëria dhe Kosova. Çfarë kanë bërë historikisht shqiptarët e Maqedonisë, të Luginës dhe të Malit të Zi për të mos e penguar ngritjen dhe ndërtimin e etnitetit politik siç është shteti i Kosovës, Republika e Kosovës. Në krahasim me serbët, roli i shtetit nacional serb për pakicën serbe në Kosovë ka qenë paternalist dhe mund të themi se vetëm në atë rast kemi të bëjmë me “shtet amë”, i cili me mjete politike, diplomatike dhe ushtarake ndërhyr në mbrojtje të tyre. Në këtë vijë është edhe insistimi i Serbisë për Bashkësinë e Komunave Serbe në veri të Kosovës. Politika në Serbi qoftë ajo në pushtet qoftë opozita besojnë se serbët jetojnë në disa nga vendet e tyre të origjinës në Ballkan “ku

⁵ Human Rights Watch, *NEN URDHËRA: Krimet e Luftës në Kosovë*, October 2001,

<https://www.hrw.org/legacy/albanian/kosovo2001/summary.pdf>

⁶ Beqir Meta, Marenglen Verli, Muhamet Shatri, *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX, Vëllimi I, Botimet Albanologjike, Tiranë 2017.*

serbët nuk mund të jenë një pakicë kombëtare”. Prandaj shteti nacional serb nuk heq dorë nga ngritja e pakicës serbe në Kosovë në një entitet me ingerenca ekzekutive duke aluduar në origjinën e tyre në “Serbinë e Vjetër”. Shteti shqiptar edhe pse me kushtetutë e ka për detyrë të mbrojë shqiptarët kudo që janë luan rolin e “vëllait të madh” dhe jo të shtetit amë. Shqipëria dhe Kosova përballë “Botës Serbe” e vendosin këtë çështje në nivelin e “raporteve ndërshtetërore”, ose bashkëpunim mes dy vendeve fqinje. Krijimi me vonesë i dy entiteteve shqiptare i detyron ata të aktrojnë si dy kombe karshi faktorit ndërkombëtar dhe akuzave të padrejta të Serbisë për Shqipërinë e Madhe.

Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut në njëfarë mënyre edhe mund të konsiderojnë se kanë dy shtete amë, edhe pse raportet me lidhshimin e Kosovës kanë qenë më të shpeshta. Kjo, shkaku i jetesës në një shtet të përbashkët në ish-RSFJ dhe një numër i madh ka prejardhje nga Kosova, por në periudhën kur ata kanë lëvizur kanë qenë pjesë e vilajetit të Kosovës me kryeqytet Shkupin, dhe edhe më vonë në periudhën e RSFJ-së, kur kufijtë republikanë nuk ishin kufij ndërshtetërorë. Sot të dy “shtetet amë” kanë ndikimin e tyre për statusin që sot shqiptarët kanë në Maqedoni, kuptohet përmes rrugëve diplomatike. Partitë politike të shqiptarëve kanë edhe partnerët e tyre në Kosovë dhe në Shqipëri, si me partitë politike ashtu edhe me qeveritë e dy vendeve. Ky raport nuk është i njëjtë me atë që bën Serbia për serbët në Kosovë. Ajo që Serbia negocion për serbët e Kosovës nuk llogaritet si ndërhyrje e një shteti në punët e brendshme të një shteti tjetër siç llogaritet ndërhyrja e qeverisë shqiptare dhe asaj kosovare në Maqedoni, Mal të Zi apo Luginë të Preshevës, edhe pse as Shqipëria as Kosova nuk negociojnë për shqiptarët e Maqedonisë ose për shqiptarët e tjerë në Ballkanin Perëndimor.

Pushtetndarja ose demokracia konsociale si mekanizëm që menaxhon paqen

Pushtetndarja (power sharing)⁷ apo demokracia konsociale që aplikohet vetëm në disa elemente në Kosovë dhe më shumë në Bosnjë-Hercegovinë që bile njihet si “Power sharing plus”, por edhe në një masë në Maqedoni paraqet një formë të menaxhimit të konfliktit dhe jo zgjidhje përfundimtare të konfliktit. Pushtetndarja në Kosovë kryesisht është një çështje apo një rezultat i komunitetit ndërkombëtar edhe pse jo në të gjitha parimet e saja. Kjo për arsye se kërkon një mbështetje të fuqishme të komunitetit ndërkombëtar në procesin e implementimit, por që në rast të tërheqjes së organizmave të sigurisë, situata në rajonin e Ballkanit Perëndimor shumë lehtë mund të shpërthejë dhe të përsëritet konflikti i tmerrshëm ndërmjet popujve të Ballkanit.⁸

Argumenti se pse ky është një imponim i faktorit ndërkombëtar mbështetet në faktin se të gjithë popujt kanë pasur ambicie për zgjerim dhe ndryshim të kufijve të njohur ndërkombëtarisht. Me përmbylljen e konflikteve pushtetndarja është imponuar si kompromis mes shteteve me kërkesa ekspansioniste për shkëmbim të territoreve.⁹ Megjithatë pushtetndarja si mekanizëm makropolitk ka potencialin e përfshirjes së të gjithëve dhe kënaqjen e të gjithëve me pushtet përmes elementeve të saja brenda një entiteti, republike apo kantoni etj. Pushtetndarja e arritur me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit në Maqedoni, Dejtoni për Bosnjën, kanë plotësuar katër elementët kryesorë të “power sharing”: koalicionet e zgjeruara,

⁷ Lijphart, Arend. “Power Sharing and Group Autonomy the 1990S and the 21 st Century,”

<https://constitutionnet.org/sites/default/files/Lijphart%20consociation.pdf> (parë për herë të fundit 06.06.2023).

⁸ Isamet Bakiu, *Pushtetndarja si instrument paqeje në Ballkan, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore i Shqiptarëve - Shkup*, Shkup, 2019.

⁹ EBW, Solving the issue of Kosovo: Is change of borders possible?, <https://europeanwesternbalkans.com/2018/08/09/solving-issue-kosovo-change-borders-possible/> (09.08.2018).

përfaqësimin proporcional (përfaqësimin e drejtë), të drejtën e vetos (Badinterin), si dhe autonominë (territoriale ose joterritoriale).¹⁰

Plani i Ahtisarit plus plus për Pavarësinë e mbikëqyrur ka garantuar një status të lartë për komunitetin serb në Kosovë përkundër gatishmërisë së tyre për pjesëmarrje dhe pushtetndarje brenda institucioneve të Republikës së Kosovës. Nëse shikojmë Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Nenin 59 që rregullon të drejtat e komuniteteve, kuptojmë se asnjë kushtetutë në rajon nuk garanton të drejta kaq të plota për komunitetet, minoritetet etj.¹¹ Krijohet përshtypja se të drejtat për minoritetin serb në raport me madhësinë e tij janë një kafshatë e madhe në gojë që nuk mund të përtypet. Duket sikur p.sh. Bashkimi i Komunave Serbe në veri që nuk kërkohet nga serbët si minoritet, por më shumë për territor aderimi dhe pranie për Serbinë në Kosovë.

Përfaqësimi proporcional dhe integrimi i serbëve në institucionet e Kosovës

Minoriteteve u garantohet me kushtetutë përfaqësim i barabartë në institucione, ndërmarrje publike, polici etj.¹² Edhe në pushtet lokal garantohet përfaqësimi i komuniteteve me nenin 62 sikur vendi i zëvendëskryetarit të kuvendit (për komunitetin 10%) si dhe zëvendëskryetarin e komunës për komunitetin jo shumicë.¹³ Edhe në legjislativin e Republikës së Kosovës, kushtetuta garanton pjesëmarrjen e komunitetit serb, dhe në rast se serbët fitojnë më pak se 10 deputetë atyre u mundëson 10 vende të garantuara.¹⁴ Kjo praktikë

¹⁰ Isamet Bakiu, *Pushtetndarria si instrument paqeje në Ballkan, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore i Shqiptarëve - Shkup, Shkup, 2019.*

¹¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës,

[https://masht.rks-gov.net/wp-](https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/04/Kushtetuta.e.Republikes.se_.Kosoves.pdf#page=25.26)

[content/uploads/2022/04/Kushtetuta.e.Republikes.se_.Kosoves.pdf#page=25.26](https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/04/Kushtetuta.e.Republikes.se_.Kosoves.pdf#page=25.26)

(parë për herë të fundit 23.03.2024).

¹² Neni 61 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

¹³ Neni 62 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

¹⁴ Neni 64 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

ka filluar si model me Kornizës Kushtetuese gjatë periudhës së UNMIK-ut kur komunitetet mund të konkurronin në zgjedhje për ulëse shtesë plus të mbajnë ulëset e garantuara si në rastin e serbëve në Kosovë në zgjedhjet e 2001. Po të kishin votuar në masë serbët ndoshta do të kishin fituar në shumë se 25 deputetë në asamblenë me 120 ulëse të Kosovës. Përkundrazi liderët serbë bënë fushatë kundër pjesëmarrjes në zgjedhje dhe kjo dërgoi një mesazh konfuz dhe e humbën këtë mundësi.¹⁵ Në Kosovën e UNMIK-ut karakteristike ishte diskriminimi pozitiv sa i përket përfaqësimit të minoriteteve në Asamblenë Parlamentare. Kaptina 9 e Kornizës Kushtetuese për qeverisje të përkohshme në Kosovë e determinononte pushtetin e minoriteteve në institucionet e Kosovës.¹⁶

Sot Kushtetuta është e qartë edhe për komunitetet e vogla: “komuniteti rom një (1) vend; komuniteti ashkali një (1) vend; komuniteti egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t’i jepet komunitetit rom, ashkali, ose egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti boshnjak tri (3) vende, komuniteti turk dy (2) vende dhe komuniteti goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara”.¹⁷ Kushtetuta u jep komuniteteve edhe përfaqësim në nivele të larta shtetërore. Dy nënkryetarë që nuk janë shumicë në Kuvend që zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve. Njëri nga komuniteti serb dhe tjetri nga komunitetet

¹⁵ International Crisis Group. “Kosovo: Landmark Election,” November, 21. 2001 Available at:

<http://www.crisisgroup.org/home/index.cfm?id=3031&l=1> September, 28. 2005

¹⁶ Constitutional Framework for Provisional Self-Government in Kosovo. Available at:

http://www.unmikonline.org/pub/misc/FrameworkPocket_ENG_Dec2002.pdf (parë për herë të fundit 09.28.2005).

¹⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës,

[https://masht.rks-gov.net/wp-](https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/04/Kushtetuta.e.Republikes.se_.Kosoves.pdf#page=25.26)

[content/uploads/2022/04/Kushtetuta.e.Republikes.se_.Kosoves.pdf#page=25.26](https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/04/Kushtetuta.e.Republikes.se_.Kosoves.pdf#page=25.26)

(parë për herë të fundit 23.03.2024).

tjera.¹⁸ Së paku një zëvendëskryesues i secilit komision parlamentar, do të jetë nga radhët e komunitetit tjetër nga ai i kryesuesit.¹⁹ Neni 78 garanton komisionin për të drejtat dhe interesat e komuniteteve 1/3 u takon serbëve, 1/3 komuniteteve dhe 1/3 komunitetit shumicë. Secili anëtar i Kryesisë së Kuvendit mund të kërkojë që ligjet të kalojnë përmes këtij komisioni.

Të gjitha këto të drejta për minoritetin serb që vijnë si rrjedhojë e Planit të Ahtisari nuk mjaftojnë edhe pse ky plan ndërkombëtar për serbët nuk është obligativ dhe nuk i detyron palët.²⁰ Beogradi vazhdimisht deklarohet se i bën koncesione dhe akuzon pse Kosova shtron çështjen e njohjes së Pavarësisë. Që nga 2005 deri në 2011 Beogradi kërkonte më shumë dhe jepte më pak.²¹ Faktikisht kjo gjë nuk i kontribuoi integritetit të serbëve në realitetin e ri të krijuar në Kosovën e pavarur, por mund të ishte një akomodim që serbët në Kosovë mund ta pranonin për fillim të procesit të integritetit. Bojkotimi i zgjedhjeve të tetorit të vitit 2004 për në Asamblenë kosovare u bë me presion të Beogradit, edhe pas zgjedhjeve serbët e Kosovës hoqën dorë nga njëra nga dy pozitat ministrore të ofruara që ishin të rezervuara për ta, gjithashtu edhe për portfoliot e zëvendësve dhe pozitat e këshilltarëve që u ishin ofruar.²² Ndërrhyrja e Beogradit

¹⁸ Neni 67/4.

¹⁹ Neni 77/3.

²⁰ Kosovo Online, “Kurtijevo pozivanje na Ahtisarijev plan - vraćanje na dokument koji pravno ne postoji”, <https://www.kosovo-online.com/vesti/analize/kurtijevo-pozivanje-na-ahtisarijev-plan-vracanje-na-dokument-koji-pravno-ne-postoji> (parë për herë të fundit 12.01.2023).

²¹ Marko Prelec dhe Naim Rashiti, “Integrimi i serbëve në Kosovë pas Marrëveshjes së Brukselit”, Balkans Policy Research Group, <https://balkansgroup.org/wp-content/uploads/2015/03/Integrimi-i-Serbeve-pas-marreveshjes-se-Brukselit1-1.pdf> (parë për herë të fundit 19.03.2023).

²² Bieber, Florian. “The Legal Framework for Post-War Kosovo and the Myth of Multiethnicity,” in Nenad Dimitrijević und Petra Kovacs ed. *Managing Hatred and Distrust: The Prognosis for Post-Conflict Settlement in Multiethnic Communities in the former Yugoslavia*, Budapest: LGI, 2004:118-135.

ka vazhduar dhe vazhdon në fokus të bojkotimit të ligjit dhe të institucioneve të Kosovës së pavarur.

Edhe në Bosnjë-Hercegovinë edhe në Kosovë përfaqësimi i komuniteteve apo minoriteteve në Parlament dhe Qeveri garantohet me kushtetutë.²³ Në Maqedoni partitë politike marrin pjesë në zgjedhje dhe për krijimin e koalicionit qeverisës negociojnë me mandatarin, i cili i takon partisë që fiton shumicën ose asaj që mund ta bëjë koalicionin udhëheqës qeveritar. Lojaliteti i shfaqur nuk pret sinjale as nga Shqipëria as nga Kosova. Ligjet me interes vital votoheshin deri tani me votim të dyfishtë mazhoritar në Parlament duke arritur në kompromis të pranueshme nga të dy grupet etnike. Përveç ligjit elektoral është edhe kërkesa kushtetuese për përfaqësim në qeveri që e ka posaçërisht Bosnjë-Hercegovina dhe Kosova.

Në Maqedoninë e Veriut nuk ka ligj për deputet për të plotësuar diskriminimin pozitiv për pakicat tjera në parlament. Nga fundi i vitit 2005, Kenan Asipi, deputet i Partisë Demokratike Turke në Maqedoni bëri një propozim në Parlament për t'u diskutuar. Propozimi kërkonte 12 ulëse të rezervuara për të përfaqësuar të gjitha komunitetet tjera në Parlamentin e Maqedonisë.²⁴ Përvoja e deritanishme tregon për koalicione parazgjedhore të partive minoritare me partitë qoftë të bllokut maqedonas ose shqiptar.²⁵ “Në Bosnjë-Hercegovinë kërkohej përfshirja e komuniteteve jodominante në qeveri, kurse në nivel të entiteteve vetëm në 2001 u mundësua përfshirja e tyre. Pjesëmarrja serbe në Federatën e Bosnjë-

²³ Bieber, Florian. Power Sharing as Ethnic Representation in Post conflict Societies: The Cases of Bosnia, Macedonia, and Kosovo. 2005:237.

²⁴ M.J. “DUI does not want Reserved Seats for the Small Ethnic Communities,” 12.09.05, Slobodna Evropa. Available at: <https://www.slobodnaevropa.mk/a/1477971.html> (parë për herë të fundit më 27.09.2023).

²⁵ Në zgjedhjet e fundit presidenciale dhe parlamentare të vitit 2024, kreu i BDI-së Ali Ahmeti krijoi Frontin Evropian me parti të minoritetit turk, boshnjak dhe rom.

Hercegovinës ka qenë minimale, kurse në Republika Sërpska ministri i parë boshnjak u caktua në qeveri vetëm në vitin 2001”.²⁶

E drejta e vetos si element i pushtetndarjes në Kosovë

Gjatë periudhës së UNMIK-ut në Kosovë nuk kishte të drejtë vetoje formale, por vetëm të drejtë të shtyhen vendimet. Korniza kushtetuese nuk e definonte kush ka kompetenca të jap interpretim kur vendimet ndërhyjnë në të drejtat e komuniteteve. Në vend të institucioneve kosovare fjalën e fundit e jepte Përfaqësuesi Special i Këshillit të Sigurimit.²⁷

Situata me serbët e Kosovës edhe në kohën e UNMIK-ut ishte se në enklavat ku jetonin ata ishin shumë të shkapërderdhura dhe nuk mundeshin të bëjnë një territor kompakt, edhe pse brenda enklavave ata gëzonin *de facto* autonomi të plotë.²⁸ Kjo tolerancë e vazhdueshme ka qenë në proporcion të kundërt me procesin e integritit të serbëve në institucionet e Republikës së Kosovës. Në Kosovë dhe Maqedoni, komunitetet nuk kanë të drejtë absolute të vetos. Zakonisht përdorimi i së drejtës për veto mund të pësojë bllokadë, e cila implikon nevojën e disa instrumenteve të tejkalojnë ngërçet në procesin e vendimmarrjes. Në Kosovë Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm caktonte një anëtar nga paneli i përbërë nga anëtarë të secilit komunitet për t’i propozuar një zgjidhje Asamblesë.²⁹ Ngjashëm edhe në Parlamentin

²⁶ Daskalovski, Zhidas. “Language and Identity: The Ohrid Framework Agreement and Liberal Notions of Citizenship and Nationality in Macedonia.” Budapest: Central European University, 2002:17.

²⁷ Bieber, Florian. “Power Sharing after Yugoslavia. Functionality and Dysfunctionality of Power Sharing Institutions in Post-war Bosnia, Macedonia and Kosovo,” in Sid Noel (ed.), *From Power-sharing to Democracy: Post-conflict Institutions in Ethnically Divided Societies*, Montreal: McGill-Queens University Press, 2004:98.

²⁸ Bieber Florian. “Institutionalizing Ethnicity in the Western Balkans. Managing Change in Deeply Divided Societies,” ECMI Working Paper, No. 19, 2004:94.

²⁹ See 9.1.40, 9.1.41, *Constitutional Framework for Provisional Self-Government*, Available at:

http://www.unmikonline.org/pub/misc/FrameworkPocket_ENG_Dec2002.pdf

boshnjak, Oda e Popujve e Federatës (the House of Peoples of the Federation) dhe Këshilli i Popujve në Republikën Sërpska aplikojnë procedurën e panelit tre anëtarësh.³⁰

Të tri rastet Bosnjë-Hercegovina, Maqedonia dhe Kosova i takojnë formës konsensuale të demokracisë. Donald Horowitz shpreh dyshim se shumica do të vetëmohojë veten. Pyetja është pse vallë liderët e shumicës që kanë 60% ose 90% të jenë vetëmohues dhe t'i japin pushtet liderëve të pakicës që janë 4-8%?³¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës kërkon gjithashtu që edhe në amendimin e ligjeve të përfshihen edhe komunitetet. “Çdo ndryshim do të kërkojë miratimin e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës”.³²

Lidhjet e minoritetit serb në Kosovë me zyrtarët serbë nga Serbia janë të fuqishme, pasi që Serbia për një kohë të gjatë ka ushtruar autoritetin në enklava ku minoriteti serb ka jetuar nën protektoratin e KFOR-it. Roli i Serbisë në Kosovë nuk ka qenë edhe aq i vogël as edhe në të kaluarën. Në nëntor 2001 bile u arrit një marrëveshje mes Hans Haekkerup dhe Nebojsa Çoviq, kryetar i Qendrës Koordinuese për “Kosovë dhe Metohi”.³³ Faktikisht kjo nuk i

(parë për herë të fundit më 10.06.2005).

³⁰ Bieber, Florian. “Power sharing after Yugoslavia. Functionality and Dysfunctionality of Power Sharing Institutions in Post-war Bosnia, Macedonia and Kosovo”, in Sid Noel ed. *From Power-Sharing to Democracy: Post-conflict Institutions in Ethnically Divided Societies*, Montreal: McGill-Queens University Press, 2004:99.

³¹ Horowitz, Donald L. *Constitutional Design: Proposals Versus Processes*. https://scholarship.law.duke.edu/faculty_scholarship/3485/ (parë për herë të fundit më 20.09.2023).

³² Neni 144/2 i Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

³³ Bieber, Florian. “The Legal Framework for Post-War Kosovo and the Myth of Multiethnicity,” in Nenad Dimitrijević und Petra Kovacs ed. *Managing Hatred and Distrust: The Prognosis for Post-Conflict Settlement in Multiethnic Communities in the former Yugoslavia*, Budapest: LGI, 2004:118-135.

kontribuoi integritet të serbëve në realitetin e ri të krijuar në Kosovë. Bojkotimi i zgjedhjeve të tetorit të vitit 2004 për në Asamblenë kosovare u bë me presion të Beogradit, edhe pas zgjedhjeve serbët e Kosovës hoqën dorë nga njëra nga dy pozitat ministrore të ofruara që ishin të rezervuara për ta gjithashtu edhe për portfoliot e zëvendësve dhe pozitat e këshilltarëve që u ishin ofruar.³⁴

Neni 81 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës garanton legjislacionin vital, i cili kërkon shumicën e votave edhe të komunitetit joshumicë. Këto ligje nuk mund t'i nënshtrohen referendumit.³⁵ Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut edhe pse e gëzojnë të drejtën e vetos/badinterit për ligjet me rëndësi jetike nuk kanë fituar të njëjtin standard të të drejtave në aspekt të së drejtës së përdorimit të gjuhës. Derisa përdorimi i gjuhës shqipe për shqiptarët e RMV limitohet me 20% e popullatës, serbishtja është gjuhë zyrtare në gjithë territorin e Kosovës.³⁶ Në nivelin e qeverisë, Kushtetuta e Kosovës gjithashtu garanton përfaqësimin e komuniteteve e sidomos të atij serb. Një ministër nga komuniteti serb dhe një ministër nga ndonjë komunitet tjetër joshumicë në Kosovë. Nëse janë më shumë se dymbëdhjetë ministra, Qeveria do të ketë edhe një ministër të tretë, i cili përfaqëson një nga komunitetet joshumicë në Kosovë. Gjithashtu

³⁴ Bieber, Florian. "The Legal Framework for Post-War Kosovo and the Myth of Multiethnicity," in Nenad Dimitrijević und Petra Kovacs ed. *Managing Hatred and Distrust: The Prognosis for Post-Conflict Settlement in Multiethnic Communities in the former Yugoslavia*, Budapest: LGI, 2004:118-135.

³⁵ (1) Ligjet të cilat ndryshojnë kufijtë e komunave, themelojnë ose shuajnë komuna, përkufizojnë shtrirjen e pushteteve të komunave dhe pjesëmarrjen e tyre në marrëdhëniet ndërkomunale dhe tejkufitare; (2) ligjet të cilat zbatojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, me përjashtim të atyre të përcaktuara me Kushtetutë; (3) ligjet për përdorimin e gjuhëve; (4) ligjet për zgjedhjet lokale; (5) ligjet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore; (6) ligjet për liritë fetare ose për marrëveshjet me komunitetet fetare; (7) ligjet për arsimin; (8) ligjet për përdorimin e simboleve, përfshirë simbolet e komuniteteve dhe për festat publike.

³⁶ Shqiptarët që në Maqedoninë e Veriut përbëjnë 29.7% të popullatës nuk kanë mundur ta gëzojnë/sigurojnë një të drejtë, të cilën ua garanton Kushtetuta e Republikës së Kosovës serbëve me 4-8% të popullatës.

edhe në nivelin e zëvendësministrave dy zgjidhen nga komuniteti serb i Kosovës dhe dy zëvendësministra nga komunitete të tjera joshumicë në Kosovë. Nëse janë më shumë se dymbëdhjetë ministra, Qeveria do të ketë edhe një zëvendësministër të tretë, i cili përfaqëson komunitetin serb dhe një tjetër zëvendësministër, i cili përfaqëson një nga komunitetet e tjera joshumicë në Kosovë.³⁷

Për dallim nga shqiptarët e Maqedonisë këto pozita garantohen me kushtetutë, ndërsa në Maqedoni vijnë si rezultat negociatash politike të mandatarit dhe të partive politike shqiptare. Kjo është një rregull e pashkruar që nuk kërkon detyrim koalicioni etnik, mirëpo është dëshmuar se ligjet me rëndësi vitale kërkojnë shumicën e dyfishtë dhe kjo mbetet praktikë e cila është dëshmuar se jo gjithnjë bëhet mes fituesit në bllokun maqedonas dhe fituesit në bllokun shqiptar. Komunitetet gjithashtu janë përfshirë edhe në juridiksionin e gjyqësorit ku të paktën pesëmbëdhjetë për qind (15%) e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, por jo më pak se tre (3) gjyqtarë, do të jenë nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.³⁸ Të paktën pesëmbëdhjetë për qind (15%) e gjyqtarëve nga cilado gjykatë tjetër e themeluar me juridiksionin e apelit, por jo më pak se dy (2) gjyqtarë do të jenë nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.³⁹

Anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës që i zgjedhin deputetët e Kuvendit, 2 zgjidhen nga përfaqësuesit e komunitetit serb në Kosovë dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtarë. Dy u takojnë komuniteteve të tjera dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar.⁴⁰ Emërimi i dy anëtarëve nga nëntë të Gjykatës Kushtetuese kërkon edhe pëlqimin e deputetëve joshumicë.⁴¹ Edhe forcat e sigurisë së Kosovës, policia, agjencia për

³⁷ Neni 97 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

³⁸ Neni 103/3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

³⁹ Neni 103/6 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

⁴⁰ Neni 108 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

⁴¹ Neni 114.

inteligjencë me kushtetutë garantojnë përfaqësimin e bazuar në shumëllojshmërinë etnike.

Të paktën një (1) nga zëvendësit e Avokatit të Popullit është pjesëtar i komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë. Në Komisionin Qendror Zgjedhor të Kosovës përveç 6 anëtarëve të grupeve më të mëdha parlamentare, një anëtar emërohet nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin serb të Kosovës dhe tre (3) anëtarë nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë.⁴²

Elementi i autonomisë territoriale - Bashkësia e Komunave Serbe në veri të Kosovës

Serbët e Kosovës të koncentruar në pjesën veriore të Mitrovicës dhe në komunat e tjera kanë vazhduar të ushtrojnë “autonominë e tyre joformale” përmes sistemit paralel serb ndryshe nga ajo në Bosnjë-Hercegovinë si një shtet i njohur ku ka një nivel të fuqishëm të autonomisë që e garanton Marrëveshja Paqësore e Dejtonit. Tolerimi i sistemit paralel që nga koha e UNMIK-ut ka mundësuar këtë ndërhyrje në Kosovë të shteti të Serbisë.⁴³ Autonomia territoriale ose joterritoriale është elementi i katërt i pushtetndarjes dhe më i rëndësishmi, por më vështirë i implementueshmi. Tendenca për ndarje të Kosovës ka pasur vazhdimisht në Kosovën ku serbët përbëjnë një përqindje të vogël (5%) dhe që jetonin në enklava. Ka pasur edhe një propozim për kantonizimin e saj nga Zoran Gjingjiq më 1999. Promovuesi i kësaj ideje është historiani Dushan Batakoviq,

⁴² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/04/Kushtetuta.e.Republikes.se_.Kosoves.pdf#page=25.26 (parë për herë të fundit 23.03.2024).

⁴³ Bieber, Florian. “Institutionalizing Ethnicity in the Western Balkans. Managing Change in Deeply Divided Societies,” ECMI Working Paper, No. 19, 2004:94 Available at: <http://www.policy.hu/bieber> (E parë për herë të fundit në 19.11.2004).

kurse në 1999 këtë e kishte lansuar edhe njëri ndër përfaqësuesit e serbëve të Kosovës, Momçilo Trajkoviç, i cili ia kishte dorëzuar propozimin Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, z. Bernard Kouchner.⁴⁴ Propozimi për ndarje të Kosovës në pesë kantone nën administrimin e Kombeve të Bashkuara dhe Serbëve u hodh poshtë nga PSSP-ja, Berenard Kouchner. Në anën tjetër shqiptarët e patën kundërshtuar fuqimisht atë propozim. Kërkesat e tilla për Arbër Xhaferin, udhëheqësin e Partisë Demokratike të Shqiptarëve (PDSH) në Maqedoni kishin gjetur arsye të ndarja e pjesës veriore të Kosovës, e cila sipas tij do të shkaktonte ndarjen e Maqedonisë dhe Luginës së Preshevës nga Serbia.⁴⁵

Lëvizja për ta bërë edhe entitetin shqiptar në Maqedoni pas referendumit për pavarësimin e Maqedonisë ku shqiptarët u degraduan në nivelin e minoritetit me Kushtetutë ishte edhe referendum për Iliridën, i cili nuk u realizua asnjëherë deri më sot.⁴⁶ Për dallim nga insistimet territoriale serbe në Kosovë, në Maqedoni zgjidhjet territoriale nuk hasin në mbështetje nga faktori ndërkombëtar, por as edhe ndonjë mbështetje të fuqishme nga kushtimisht t'i quajmë shtet amë si Shqipëria dhe Kosova.⁴⁷

⁴⁴ Karl Gersuny, "Ethnic cantons are a reality anyway", TAZ.de <https://taz.de/Ethnische-Kantone-stellen-ohneine-Realitaet-dar/!1273507/> (parë për herë të fundit më 12.09.2023).

⁴⁵ V.H. Arbër Xhaferi: "Ndarja e Kosovës sjell ndarjen e Maqedonisë," trans. The Division of Kosovo Leads Toward Division of Macedonia. 27.09.2005, Available at: <http://www.lajmet.com/index.php> September, 27. 2005.

⁴⁶ Referendumi i mbajtur me sukses për autonomi politike territoriale i 8 prillit 1992 ishte kundërpërgjigje ndaj të gjitha vendimeve të njëanshme të faktorit politik maqedonas, të cilët anashkaluan skajshmërisht interesat kombëtarë të shqiptarëve të Iliridës në IRJM. Referendumi i popullit shqiptar të Iliridës IRJM u mbajt më 11 e 12 janar, 1992. Vendimin për shpalljen e referendumit për autonomi politike dhe territoriale të shqiptarëve në IRJM e solli Kuvendi i Autonomisë më 27 dhjetor 1991. Qytetarët shqiptarë duhej të deklaroheshin se: A janë për Autonomi politike territoriale të shqiptarëve në Maqedoni.

⁴⁷ Pika e 2 e MKO në parimet themelore kundërshton zgjidhjet territorial. https://mls.gov.mk/images/laws/Marrevshja_e_Ohrit.pdf (parë për herë të fundit, 15.09.2023).

Në raportin e Grupit Ndërkombëtar të Krizave (International Crisis Group) theksohej se komuniteti ndërkombëtar duhet të “mbështes Kosovën multietnike dhe të unifikuar duke garantuar një autonomi dhe siguri për serbët nga dominimi shqiptar dhe duke e bërë të qartë se nuk do të ketë kthim të Beogradit e as shpëputje të Kosovës”.⁴⁸ Zgjidhja territoriale vazhdimisht është sjell në kokat nacionaliste serbe të cilët në pamundësi të kontrollit hegjemon duan së paku të shkëpusin një territor sadopak homogjen serb si që janë komunat në veriun e Kosovës. Frika e shqiptarëve si shumicë ka të bëjë me ndarjen e Kosovës edhe pse ekzistojnë opinion pro dhe kundër. Slogani i përdorur në zgjedhjet lokale 2013 “sot ne votojmë për [listën] “Sërpska”, nesër ndërtojmë [Republika] Sërpska” ishte alarmante.⁴⁹

Shqiptarët e Maqedonisë gjithmonë kanë qenë të kujdesshëm për mos e penguar procesin politik të shqiptarëve të Kosovës. Që në kohën e pluralizmit politik qëndrimi i subjekteve politike shqiptare në Maqedoni ka bërë thirrje që mos të nxitohet pa u përmbyll çështja e Kosovës. Edhe në periudhën pas luftës së 2001 akoma nuk është bërë ndonjë kërkesë për zgjidhje territoriale. Këtë nuk e ka kërkuar as shteti shqiptar as Republika e Kosovës. Integrimi në sistemin politik të Maqedonisë së Veriut i ka kontribuar paqes në Ballkanin Perëndimor dhe jo konfliktit dhe tensioneve. Në raportin e Balkans Policy Research thuhej se “Qeveria e Kosovës shqetësohet se krijimi i Asociacionit të Komunave Serbe mund të prishë harmoninë, të pengojë shtetin dhe të rrisë tensionet mes serbëve dhe shqiptarëve. Po ashtu, ajo i frikësohet futjes së një niveli administrues të tretë, të

⁴⁸ International Crisis Group. “Bridging Kosovo's Mitrovica Divide”, Available at: <https://www.crisisgroup.org/europe-central-asia/balkans/kosovo/bridging-kosovos-mitrovica-divide>

(parë për herë të fundit më 19.09.2023).

⁴⁹ Marko Prelec dhe Naim Rashiti, “Integrimi i serbëve në Kosovë pas Marrëveshjes së Brukselit”, Balkans Policy Research Group, <https://balkansgroup.org/wp-content/uploads/2015/03/Integrimi-i-Serbeve-pas-marreveshjes-se-Brukselit1-1.pdf> (parë për herë të fundit, 19.03.2023).

përcaktuar etnikisht, i cili do të rriste rrezikun e ndarjes në të ardhmen. Serbët kërkojnë vetëm një entitet të ndërmjetëm që do t'i izolojë nga Prishtina dhe do të ruajë lidhjet e tyre me Beogradin”.⁵⁰

Përderisa insistimi serb konsideron asociacionin e komunave si thelbin e marrëveshjes së Brukselit, është e qartë pse serbët insistojnë në elementin e katërt të pushtetndarjes që është autonomia territoriale. Autonomia territoriale hap rrugë për zgjidhje tjera makropolitike në të ardhmen që mund ta arsyetojë frikën e qeverisë së Republikës së Kosovës. Për dallim nga shqiptarët në Maqedoninë e Veriut që negociojnë përmes përfaqësuesve politikë, për serbët e Kosovës negocion Beogradi. Derisa përfaqësuesit politikë shqiptarë nuk insistojnë në zgjidhje territorial, Beogradi insiston në zgjidhje territoriale për serbët dhe kjo nuk kundërshtohet nga faktori ndërkombëtar, ndërsa shqiptarëve u ndalohet zgjidhja territoriale me Marrëveshjen e Ohrit. Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut në këtë aspekt shpresojnë në një decentralizim të zgjeruar të pushtetit lokal në vend të një Bashkësie autonome komunash.

Ndikimi i shteteve amë në relacion me mbrojtjen e të drejtave të pjesëtarëve të etnikumeve të tyre dallon dukshëm. Roli i Serbisë për minoritetin serb në Kosovë është dukshëm më agresiv në krahasim me atë të Shqipërisë për shqiptarët e Maqedonisë dhe të Luginës ose nga ai i Kosovës për këto të fundit. Si do të jetë veprimi i Beogradit në Kosovë pa e dëmtuar shtetin e Kosovës? Serbia ka arritur ta ngrejë çështjen e minoritetit serb në nivel të UE-së dhe bile në nivel ndërkombëtar, por njëkohësisht ka penguar integrimin e minoritetit në institucionet vendore të Republikës së Kosovës. Faktori ndërkombëtar në raport mes shqiptarëve dhe serbëve ka luajtur dhe po luan politikë të standardeve të dyfishta. Derisa serbëve u lejon zgjidhje territoriale dhe njënacionale, shqiptarëve ua mohon këtë. Edhe për shqiptarët e Maqedonisë së Veriut nuk lejon zgjidhje territoriale, por gjithashtu edhe bashkimin e popullit shqiptar të Kosovës me shtetin shqiptar e trajton si secesionizëm. Nga ana tjetër edhe ndarjen eventuale të

⁵⁰ Po aty.

Republikës Sërbska dhe bashkimin e saj Republikës së Serbisë e konsiderojnë secesionizëm të rrezikshëm, i cili mund të rezultojë me mosekzistimin e Republikës Sërbska.

A është nevojë politike dhe a ka bazë ligjore kërkesa për bashkimin e komunave serbe në veri dhe sa paraqet obligim kjo për shtetin e Kosovës? Mosbindja ndaj autoriteteve legjitime kosovare, ndaj zgjedhjeve të lira, ndaj institucioneve i përjashton ato vetë nga gëzimi i të drejtave juridike të cilat garantojnë plotësimin e nevojave qytetare. Involvimi i shtetit serb vetëmse dëmton integrimin e tyre dhe paqen në Kosovë për shkak se Kosova është një demokraci dhe nuk është një shtet autoritar dhe oligarkik. *De fakto* një minoritet prej 4-5% nuk do mund të dëmtojë demokracinë kosovare, por nëse një nevojë sikur ajo e “Bashkimit të Komunave Serbe të Veriut” bëhet për t’u përdorë si “Kalë Troje” që Serbia ta garantojë praninë e saj në Kosovë, atëherë kjo mund të shkaktojë reperkusione të vazhdueshme si për kosovarët ashtu edhe për komunitetin demokratik perëndimor.

Roli i shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut është shumë i rëndësishëm në këtë aspekt për arsye se nuk ka dhënë precedent siç mund të ishte bashkimi i komunave të shqiptarëve të Maqedonisë. Kjo ide edhe si metodë kërcënuese nuk është pranuar të bëhet për ta parandaluar efektin domino në Kosovë. Shqiptarët e Maqedonisë ose subjektet politike nuk kanë ndonjë lloj institucioni autonom përveç organizimit në blloqe politike. Integrimi i shqiptarëve të Maqedonisë është vënë në shërbim të ruajtjes së shtetit unitar të Maqedonisë së Veriut dhe kështu është si një shembull konkret për serbët e Kosovës se integrimi është opsioni më i mirë për paqen afatgjate në rajon. Mirëpo involvimi i politikës aktuale serbe pengon integrimin e serbëve dhe dallon nga qasja që ka shteti shqiptar për shqiptarët e Maqedonisë ose atyre të Luginës së Preshevës ose të Malit të Zi. Politika aktuale e Serbisë ka për qëllim final kthimin me ushtri dhe pushtet mbi Kosovën dhe atë nuk e fshehin as përfaqësuesit kishtarë që deklarojnë se edhe 500 vjet nuk janë shumë për t’u kthyer në Kosovë. Kjo qasje është një alarm për shqiptarët për të qenë të përgatitur për çfarëdo lloj momenti.